

## **Punëtori pasuese e takimit rajonal me Avokatin e Popullit “Roli i komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në avancimin e jetës multietnike në Strugë”**

Më 11.06.2008 në Strugë u mbajt punëtori në temë **“Roli i komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në avancimin e jetës multietnike në Strugë”**. Punëtorja është pjesë e aktiviteteve të parapara me projektin **Jetesa në mjedis multikulturor – Qytetarë me të drejta, mundësi dhe mbrojtje të barabartë**, i financuar nga Komisioni Evropian dhe Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

Në punëtorinë tematike morën pjesë gjithsej 32 pjesëmarrës: përfaqësues nga komuna e Strugës, këshilltarë nga këshilli i komunës së Strugës dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare që punojnë me çështjet e pakicave. Mundësi për pjesëmarrje në diskutim kishin të gjithë pjesëmarrësit me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimi dhe komunikimit mes aktorëve relevant.

Në punëtorinë tematike u diskutua për bashkëpunimin dhe komunikimin e pamjaftueshëm mes këshilltarëve dhe anëtarëve të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive, komunës dhe organizatave joqeveritare, si edhe për tejkalimin e këtyre problemeve. U qartësua roli i Komisionit dhe nevoja për bashkëpunim më të afërt me Këshillin gjatë zgjidhjes së çështjeve kyçe për bashkëjetesën në Strugë. Pas kësaj, u bisedua edhe për dispozitat normative në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe nevoja për përcaktim më preciz të kompetencave të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive.

Punëtorinë tematike e organizoi FISHHM në bashkëpunim me Shoqatën për Zhvillim dhe Aktivizëm “Akva” nga Struga (ish Qendra për Përkrahje të OJQ-ve nga Struga).